



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
**Kuvendi - Skupština - Assembly**

---

**Legjislatura V**

**Sesioni pranveror**

**Komisioni për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media**

Mbledhja nr. 38

Prishtinë, më 17.5.2016, ora: 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S-II

**Procesverbal**

Në mbledhje morën pjesë: Zenun Pajaziti, Sadri Ferati, Kujtim Paçaku, Xhevahire Izmaku dhe Alma Lama.

Munguan: Shqipe Pantina, Pal Lekaj, Zafir Berisha dhe Jelena Bontiq.

Në mbledhje morën pjesë: përfaqësuesit e MAP-së, Avokatit të Popullit, OSBE-së, NDI-së dhe KDI-së.

Nga stafi mbështetës i Komisionit: Drita Morina dhe Mirjeta Heta.

Mbledhjen e kryesoi: Zenun Pajaziti, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky rend i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e kaluara;**
- 3. Rishqyrtimi i Projektligjit për Procedurën e përgjithshme administrative;**
- 4. Të ndryshme.**

**1. Miratimi i rendit të ditës;**

**Zenun Pajaziti**, në fillim të mbledhjes kërkoi nga përfaqësuesit e MAP-së, pjesëmarrës në mbledhje të japin sqarimet e tyre për amendamentet e hartuara, me vërejtjet e Komisionit për Legjislacion.

**Naser Shamolli**, drejtor i zyrës ligjore të MAP-së, tha se të gjitha sqarimet për amendamentet janë dhënë në mbledhjen e mbajtur me anëtarët e Komisionit për Legjislacion dhe nëse nuk ka vërejtje të tjera, pas mbledhjes është sqaruar për të gjitha propozim- ndryshimet.

**Alma Lama**, kërkoi sqarime nga përfaqësuesit e MAP-së rreth vërejtjeve të saj për parimin e administratës së hapur.

**Përfaqësuesi i Avokatit të Popullit**, tha se vërejtjet e institucionit që drejton janë komente në lidhje me disa nene dhe rreth renditjes së parimeve, të cilat nuk janë vërejtje konkrete për nene të caktuara.

**Naser Shamolli**, duke iu përgjigjur, tha se parimi i administratës së hapur është zëvendësuar me parimin e publicitetit.

**Alma Lama**, pyeti, pse mbledhjet e organeve të administratës janë të mbyllura?

**Naser Shamolli**, tha se në mbledhjet ku shqyrtohen emra, konform ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale, mbledhjet janë të mbyllura.

**Zenun Pajaziti**, kërkoi nga anëtarët e Komisionit të votohen amendamentet veç e veç.

Nga të gjitha amendamentet, nuk është votuar vetëm amendamenti për nenin 9, të tekstit të Projektligjit, që do të thotë se mbetet teksti si në Projektligj.

Konstatim: Komisioni njëzëri votoi për të gjitha amendamentet, me përjashtim të amendamentit për nenin 9 të Projektligjit, si në vijim:

#### **Amendamenti 1**

**Neni 4 paragrafi 4**, fshihen “apo diskrecioni”.

#### **Amendamenti 2**

Titulli i **nenit 10**, ndryshohet si vijon: “**Parimi i joformalitetit dhe efikasitetit të procedurës administrative**”.

#### **Amendamenti 3**

Titulli i **nenit 13**, ndryshohet si vijon: “**Parimi i të drejtës në mjete juridike**”.

#### **Amendamenti 4**

**Neni 25**, pas paragrafit 6, shtohet paragraf i ri 7, me formulimin si vijon: “**Zgjidhja e konfliktit të kompetencës, sipas paragrafit 3 të këtij neni, bëhet brenda 10 ditëve**”.

#### **Amendamenti 5**

**Neni 132.6, ndryshohet si në vijim: "Ankesa nuk do të përkeqësojë situatën juridike në dëm të palës që ka paraqitur ankesë, përpos nëse shprehimisht është paraparë ndryshe me Ligj".**

Mbledhja përfundoi në orën: 11:50.

**E përgatiti:**

**Njësia për Mbështetjen e Komisionit.**

**Kryetari i Komisionit,**

-----  
**Zenun Pajaziti**